Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Kreshnik Spahiu:	05.05.2022	16.05.2022	117/22
Emri dhe Mbiemri i Ekspertit Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datë 29.04.2022, Operatori Ekonomik (OE) "Botek" Sh.P.K - Prishtinë ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), evidentuar me numër të lëndës 117/22, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) për anulimin e aktivitetit të prokurimit: "Furnizimi dhe implementimi me Licenca të Microsoft-it për nevoja të Institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Edukimit", me numër të prokurimit: 214-20-7360-111, iniciuar nga AK–Ministria e Punëve të Brendshme.
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë te hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 12.000.000,00 €.

Për këtë aktivitetet të prokurimit OSHP ka trajtuar më herët ankesat e parashtruara nga OE që kanë dorëzuar ofertë në këtë aktivitet të prokurimit. Dhe për të njëjtat është përpiluar Raporti i Ekspertit Shqyrtues numër 55,58/21 i datës 10.02.2021 dhe Paneli Shqyrtues i OSHP-së me datë 23.03.2021 ka nxjerr vendimin PSH. 55,58/21. Poashtu në lidhje me këtë aktivitet janë parashtruar ankesat 475/480/21, 681/21 për të cilat është dorëzuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues numër 475,480/21 me datë 02.07.2021 si dhe Raporti 681/21 i datës 27.09.2021

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura

Shkeljet e dispozitave te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092:
- Neni 1 i LPP Nr. 04/L-042 Qëllimi;
- Neni 7 i LPP Nr. 04/L-042 Barazia në Trajtim/Jo-diskriminimi;
- Neni 8 i LPP nr. 04/L-042 Planifikimi i Prokurimit;

- Neni 51 i LPP nr. 04/L-042 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes;
- Neni 59 i LPP nr. 04/L-042 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
- Neni 60 i LPP nr. 04/L-042 Kriteret për Dhënien e Kontratës;
- Neni 62 i LPP Nr. 04/L-042 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit;
- Neni 112 i LPP nr. 04/L-042 Efekti pezullues i ankesave;
- Neni 113 i LPP nr. 04/L-042 Shqyrtimi fillestar nga Eksperti Shqyrtues;

Shkeljet e dispozitave - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik- A0l
- Pika 44.6 e RRUOP Ndërprerja e Procedurave të Prokurimit.

Pretendimet ankimore

Pas Njoftimit nga ana e Autoritetit Kontraktues, për anulimin e procedurës se prokurimit, ne me Kërkesën për Rishqyrtim (datë 20.04.2022), kundërshtuam atë njoftim. Mirëpo, nga ana e AK deri me tani nuk kemi pranuar asnjë vendim mbi Kërkesën tonë për Rishqyrtim, vetëm një njoftim përmes e-mailit (datë 22.04.2022) (prova 1), ku thuhet se "Kërkesa për Rishqyrtim në këtë fazë nuk ka bazë ligjore" pavarësisht se në Njoftimin për Anulimin e Procedurës jepet Këshilla ligjore sipas Nenit 108/A të LPP. Ndërkohë, vet AK shkel ligjin ne mënyrë flagrante, duke dërguar këtë njoftim dhe thirret ne: "Një Nen i LPP-se kërkon Anulimin e kësaj Procedure të Prokurimit" ndërkohë që në Arsyetimin e dhënë ne këtë Njoftim NUK përmendet asnjë Nen i LPP-së, por përmendet një Neni Ligjit të Procedurave të Përgjithshme Administrative.

Ne vijim po e shtjellojmë në forme kronologjike gjithë situatën:

I. Përshkrim i gjendjes faktike

1. Me date 09.11.2020 AK ka iniciuar tenderin me numër te prokurimit 214-20-7360-1-1-1.
2. Me date 30.12.2020 AK ka nxjerre vendim me te cilin: "lnfosoft System" sh.p.k, është rekomanduar për kontrate, ku ndaj këtij vendimi kemi bere Kërkesë për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues, e me pas ankese pranë OSHP-se.
3. Me date 24.03.2021., Paneli Shqyrtues i OSHP-se, ka nxjerre vendimin me numër PSH.nr.55-58/21, ku është aprovuar si e bazuar ankesa jonë.
4. Me datë 27.08.2021 AK ka nxjerre vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit me numër 214-20-7360-1-1-1, ndaj të cilit vendim kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e më pas ankesë pranë OSHP-se.
5. Me date 15.09.2021, KRPP jep interpretimin ligjor, kur qartëson se ne çfarë rrethana dhe në bazë të cilit nen të LPP-se mund të anulohet një aktivitet i prokurimit, pas hapjes së ofertave.
6. Me date 21.09.2021., pas ankesës se bere ne lidhje me vendimin për anulimin e aktivitet it te prokurimit me numër 214-20-7360-1-1-1, eksperti i angazhuar nga OSHP, ka nxjerre Raport Shqyrtues, ku ka dhënë mendimin se ankesa duhet te aprovohet dhe te anulohet vendimi i Autoritetit Kontraktues, për anulimin e aktivitetit te prokurimit me numër 214-20-7360 -1-1-1.

7. Me date 15.04.2022, AK ka nxjerre "Njoftimin për Anulim te Aktivitetit te Prokurimit" (prova 2), te cilin nuk e ka bazuar ne asnjë Nen te LPP-se, por thirret ne Nenin 135 pika 3 te Ligjit 05 L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Pra, AK (MPB) ne njoftimin për anulimin e aktivitetit te prokurimit, te datës 15.04.2022, ne këtë dokument precizohet se "data e vendimit për anulim e procedurës është date 13.04.2022". Një Vendim i tille i supozuar, nuk është i publikuar fare ne Platformën Elektronike nga ana e AK-se, dhe dyshimet tona te bazuara janë se NUK ekziston një Vendim i tille.
Për me tepër, ne si GOE me date 23.02 2022 kemi pranuar "Letrën Standarde për sqarimin e tenderit" prova 31, dhe ne baze te këtij dokumenti AK (MPB) sqaron se kjo procedure pavarësisht faktit se ka kaluar një periudhe te gjate qe kur është e pezulluar nga ana e OSHP-se ne mungese te bordit dhe se për këtë lende është nxjerre vetëm Raporti Ekspertit nr. 681/21(dt29.09.2021) është futur serish ne procedurën e Ri-vlerësimit.
Pra, duke u mbështet ne këtë dokument konstatojmë se AK i ka filluar procedurën e Ri-Vlerësimit duke autorizuar një Komision përkatës brenda AK dhe rrjedhimit fakti se AK NUK ka publikuar një Vendim përkatës te bazuara ne Raportin e Komisionit Rivlerësues, del se ky Komision ende NUK ka përmbyllë Raportin e tij dhe se Njoftimi për Anulim i datës 15.04 2022 del te mos jete i bazuar fare ne asnjë Raport te Rivlerësimit I Vendimit formal te ndonjë Komisioni përkatës për Ri-vlerësimin e procedurës.
Nga kjo rrjedh se AK Njoftimin për Anulim te cilin e ka publikuar, është nxjerr krej1tesisht ne forme arbitrare edhe ne kundërshtim edhe me vet procedurat te brendshme administrative pranë AK.

Njoftimi ne fjale, është një përpjekje e radhës për te arsyetuar vendimin e kundërligjshëm për Anulimin e kësaj procedure te prokurimit, pasi edhe sipas interpretimit ligjore KRPP-se dhe Raportit te Ekspertit shqyrtues te kësaj lende, AK nuk ka pas dhe nuk ka asnjë arsye ligjore që te anuloj ketë aktivitet, përderisa ka një OE te përgjegjshëm.

KRPP ne interpretimin ligjor te datës 15.09.2021, qartëson se: "Përderisa aktiviteti i prokurimit është i pezulluar, autoriteti kontraktues nuk mund te vazhdoje me procedurat e prokurimit për mbylljen e atij aktiviteti te prokurimit, qofte me dhënie te kontratës apo me anulim" (prova 4) Ndërsa, Eksperti shqyrtues ne raportin e tij nr. 683/21 te datës 27.09.2021, konstaton se duke u bazua ne nenet 62 & 112 te LPP "Autoriteti Kontraktues nuk ka diskrecion te heqë pezullimin e aktivitetit ne këtë faze" (prova 5) Raporti i ekspertit është nxjerre pas ankesës nga ana jone, pas anulimit te procedurës nga AK, me arsyetime dhe baza ligjore krejtësisht te ndryshme te Ligjit për Procedure e Përgjithshme Administrative dhe jo LPP !

Se oferta jone teknike dhe administrative është përgjegjshme kjo ishte e Konfirmuar nga vet AK ne Vendimi e tyre dhe "Letrën Standarde për tenderuesin e pasuksesshëm" (prova 6} si dhe Ri konfirmuar nga OSHP përmes një Vendimi shtese.

Vendimi i AK, për anulimin e aktivitetit te prokurimit, është i kundërligjshëm, i pabazuar dhe jashtë kompetencës se AK, sepse janë ndërmarr veprime për një lende e cila nuk ndodhet ne përgjegjësinë e tyre, pasi qe kjo lende ndodhet ne shkallen e dyte te ankimimit - OSHP. Për me tepër, pas parashtrimit

te ankesës paraprake, është dhënë një opinion/mendim i ekspertit, i cili ka rekomanduar qe ankesa e jone te pranohet si e bazuar dhe te anulohet Vendimi i AK".

Autoriteti Kontraktues ne Njoftimin mbi anulimin e aktivitetit te prokurimit, thirret ne LPP: "Një dispozite ne Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit te prokurimit". Mire po çuditërisht AK nuk përmend asnjë Nen te Ligjit te Prokurimit Publik, par një Nen te Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili ne asnjë rrethane nuk rregullon procedurat e prokurimit.

Ashtu sikurse ka konstatua edhe Eksperti i kësaj lende, sikurse vet Vendimi për anulim, ashtu edhe Njoftimi për Anulim NUK plotëson kriteret e përcaktuara nga LPP për rastet kur mund te behet përfundimi i një Aktiviteti te Prokurimit"

Pra, AK ka publikuar një njoftim, i cili nuk ka asnjë baze ligjore dhe është plotësisht ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se, veçanërisht me:
- Nenin 62 i LPP Nr. 04/L-042 Përfundimi i Aktivitetit te Prokurimit; si dhe
- Pika 44.6 e RRUOPP Ndërprerja e Procedurave te Prokurimit.

Publikim jo i plote i Formularit 858 Njoftim mbi Vendimi e Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues (MPB), me date 15.04.2022, ka nxjerrë një njoftim mbi vendimin e AK, për aktivitetin e prokurimit nr. 214-20-7360-1-1-1, përmes te cilit njoftim është "Ri-ANULUAR" ky aktivitet i prokurimit.

Te lejosh te drejtën e parashtrimit te ankesës dhe te mos pritet shqyrtimi i saj nga organi kompetent, ne këtë rast OSHP, është mohim i te drejtës themelore, e cila është edhe e drejte kushtetuese, pasi qe me Kushtetute është e garantuar ekzistimi i dyshkallesise. Pra AK ne mënyrë flagrante mohon te drejtën tone, duke vepruar jashtë kompetencave te saja.

Me rastin e publikimit fillestar te këtij tenderi, qellim ka qene gjetja e një Operatori Ekonomik te përgjegjshëm, për kryerjen e shërbimeve sipas dosjes se tenderit, dhe se konform kësaj, kompania jone ka ofertuar, dhe tashme është i vetmi OE i përgjegjshëm. Pra ne këtë kuptim, është arritur qëllimi për te cilin Autoriteti Kontraktues ka shpallur tender dhe janë plotësuar te gjitha kushtet për shpërblim me kontratë.

Shpallja e tenderit, objekt i kësaj kërkese, i ka paraprirë procedurave te cilat janë ndjekur, si ajo e zotimit te mjeteve për kryerjen e punëve dhe se çdo vendim për anulimin e këtij tenderi është tendence për te vepruar jo drejte, dhe ne kundërshtim me dispozitat qe rregullojnë qarte se kur një aktivitet i prokurimit mund te anulohet. Pra, AK ne këtë faze, duke pasur një OE te përgjegjshëm, te konfirmuar edhe me vendim te OSHP-se dhe Eksperteve te prokurimit, nuk ka asnjë arsye dhe baze ligjore qe te anuloj këtë aktivitet te prokurimit. Gjithë këto tentime te AK për te anuluar jashtëligjshëm për te dytën here aktivitetin e prokurimit, pavarësisht qe ka një OE te përgjegjshëm, jep indikacione për tendencat e kriminale te zyrtareve brenda AK, për manipulim te procedurës, për qëllime te përfitimeve te tyre

personale!

Pra, Njoftimi mbi vendimin për rianulim te këtij aktiviteti te prokurimit, është përsëritje e veprimeve te gabuara te AK-se, pasi qe me Ligj te Prokurimit Publik janë definuar me përpikëri rrethanat dhe kushtet qe duhet te plotësohen qe një AK te mund te anuloj një Aktivitet te Prokurimit, pas hapjes se ofertave. E ne ketë situate,. duke qene një OE i përgjegjshëm, konfirmuar edhe nga OSHP, si organi me i larte i prokurimit ne procedure administrative, nuk është plotësuar asnjë rrethane qe do lejonte AK te beje anulimin e këtij aktiviteti te prokurimit.

Njoftimi mbi vendimin për anulimin e aktivitetit te prokurimit ne fjale, duke u bazuar ne dispozitat e cituara ne njoftimin e dorëzuar është ne Kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe si i tille ky vendim përben veprim te kundërligjshëm, gjegjësisht Keqpërdorim te Detyrës Zyrtare, sipas nenit 414, te Kodit Penal nr. 04/L-082, dhe Keqpërdorim dhe Mashtrim ne Prokurim Publik, nga neni 415, i Kodit te njëjte.

II. Njoftimi/vendimi i kundërligjshëm Njoftimi mbi vendimin për anulimin e aktivitetit te prokurimit me numër te prokurimit 214-20-7360-1-1-1, i datës 15.04.2022, është ne kundërshtim me dispozitat e cituara me poshtë:

1. Ne Kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës
- Ne kundërshtim me nenin 3, sepse ne si OE, nuk jemi trajtuar te barabarte para ligjit, pasi qe ne një proces te filluar, ku është kërkuar një OE i përgjegjshëm dhe ne kemi plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga AK ne Dosjen e Tenderit, pra jemi një OE i përgjegjshëm, konform LPP-se është dashur te shpërblehemi me kontrate, sikurse OE te tjerë, kur ata shpallen te përgjegjshëm. Mirëpo, ne rastin tone, nga AK jemi trajtuar jo te barabarte para ligjit, duke na injoruar te drejtën tone, e cila e drejte është vërtetuar ne shkallen e fundit, atë te OSHP-se.

2. Ne kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 04/L-042
- Ne kundërshtim me nenin 1, sepse është vepruar ne kundërshtim me qëllimin e këtij ligji, pasi procedura e prokurimit, gjegjësisht ky aktivitet i prokurimit, ka filluar pas një planifikimi te bere, e qe konform nenit 1, te këtij ligji, zyrtaret përgjegjës, qe udhëheqin këtë aktivitet te prokurimit, duhet te sigurojnë efikasitet, transparence, integritet dhe përgjegjësi, dhe se ~do veprim i këtyre zyrtareve: te mos ndikohen nga interesat personale, me jo-diskriminim, me shkalle te larte te transparencës, ne përputhje te plote me kërkesat procedurale dhe qenësore te këtij ligji.
- Ne kundërshtim me nenin 7, pasi qe, duke qene se te gjithë OE e tjerë pjesëmarrës, me veprimet e tyre, gjegjësisht me mos vazhdimin e vlefshmërisë se sigurimit te tenderit, dhe veprime te tjera, janë shpallur te papërgjegjshëm, dhe duke qene se vetëm ne kemi mbetur OE i vetëm i përgjegjshëm, atëherë, me njoftimin mbi vendimin për anulim te datës 15.04.2022, kompania jone trajtohet ne mënyrë jo te barabarte.
- Ne kundërshtim me nenin 8, pasi qe me njoftimin mbi vendimin për anulimin e aktivitetit është vepruar ne kundërshtim me kërkesën e njësisë kërkuese, e cila ka bere planifikimin qe ta marr këtë shërbim nga një OE i përgjegjshëm teknikisht dhe administrativisht, dhe për te cilin shërbim dhe planifikim, zyrtaret e prokurimit, janë te thirrur qe t'i udhëheqin procedurat e prokurimit, konform LPP-se.

- Ne kundërshtim me nenin 51, pasi qe është anuluar aktiviteti i prokurimit, pas hapjes se ofertave, ku kompania jone, ka plotësuar te gjitha kriteret e kërkuara ne dosjen e tenderit, dhe se AK nuk mund te anuloj një aktivitet te prokurimit, duke injoruar faktin se ka një OE te përgjegjshëm, i cili përmbush kriteret e përzgjedhjes.
- Ne kundërshtim me nenin 59, pasi qe, AK është i detyruar qe një tender ta konsideroj te përgjegjshëm, nëse tenderi/oferta është ne përputhje mete gjitha kërkesat e parashtruara ne Dosje te Tenderit. Se oferta jone është e përgjegjshme, është konstatuar me vendime te OSHP-se, mendimet e ekspertit shqyrtues dhe nga vet AK.
- Ne kundërshtim me nenin 60, pasi qe, duke qene OE i vetëm i përgjegjshëm teknikisht dhe administrativisht dhe me ofertën brenda buxhetit te planifikuar, me nxjerrjen e Njoftimit mbi vendimin për anulim te aktivitetit te prokurimit, AK vepron ne kundërshtim me ketë nen, i cili nen e obligon AK-ne, qe t'i jap kontratën publike OE te përgjegjshëm, me çmimin mete ulet.
- Ne kundërshtim me nenin 62, i cili nen, specifikon 3 rrethana se kur Autoritetet kontraktuese mund te përfundojnë një aktivitet te prokurimit pas hapjes se ofertave. Ndërsa, arsyeja e dhënë nga AK me rastin e anulimit te këtij aktiviteti te prokurimit nuk gjen mbështetje ne këtë nen. Se ne ~fare rrethana mund te anulohet një aktivitet i prokurimit, është sqaruar edhe nga KRPP ne interpretimin e tyre ligjor te datës 15.09.2021. (bashkangjitur Ankesës si Prova 3)
- Ne kundërshtim me nenin 112, pasi qe AK, duke qene ne dijeni se keni bere ankese ne OSHP, paste cilës ankese, ka pezulluar zbatimin e aktivitetin te prokurimit, dhe konform këtij neni, AK obligohet qe automatikisht ta pezulloj çdo veprim për ketë aktivitet te prokurimit. Dhe ~do veprim, para veprimit te OSHP-se, është i kundërligjshëm dhe jo kompetent.
- Ne kundërshtim me nenin 113, pasi qe konform obligimit ligjor, OSHP ka caktuar ekspert shqyrtues, i cili ekspert ka kryer ekspertizën e tij, dhe i njëjti, ne ekspertizën e tij ka konstatuar site bazuara te gjitha pretendimet tona, si dhe ka rekomanduar aprovimin e ankesës tone, dhe konform saj, AK është dashur te pret vendimin nga Bordi Shqyrtues i OSHP-se, ose AK te rishqyrtoj vendimin e saj, duke u bazuar ne gjetjet e ekspertit, konstatimin e tij dhe rekomandimin e tij.

3. Është thirrur gabimisht ne Ligjin nr. 05 L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 135 pika 3 lidhur me nenin 100):,
Ne njoftimin e datës 15.04.2022, AK anulimin e aktivitetit te prokurimit e ka bazuar ne nenin 135, pika 3 te LPPA-se, i cili nen, nuk ka te beje fare me gjendjen faktike te aktivitetit te prokurimit, dhe se kjo dispozite rregullon një situate krejtësisht tjetër. Kjo dispozite specifikon se organi publik mund ta anuloj një akt administrativ, por aktet qe mund te anulohen, janë aktet qe janë te kundërligjshme, dhe nuk mund te anulohet një akt administrativ, te cilin ligji i veçantë, ne këtë rast Ligji i Prokurimit Publik, nuk e lejon anulimin e saj, gjegjësisht rregullon rretha1nat kur një akt ne procedurën e prokurimit mund te anulohet. E ne rastin tone, nuk lejohet anulimi i saj, aq me pak, kur OSHP, si organ i shkalles se dyte, ne vendimin e saj i aprovon pretendimet tona, bashke me ekspertin shqyrtues. Rrjedhimisht, AK ka qene i obliguar qe te kenë parasysh gjetjet dhe konstatimet e OSHP-se ne vendimin e saj, dhe rivlerësimi nga AK ka qene obligativ, nen frymën e konstatimit dhe vendimit te OSHP-se, dhe ~do vendim ndryshe, është moszbatim i vendimeve te shkalles me te larte. <;:do moszbatim i vendimeve te shkalles me te larte, natyrisht qe paraqet edhe veprim te kundërligjshëm, qe ndiqet edhe sipas detyrës zyrtare nga organet e ndjekjes.

Pika 3 e nenit 135, precizon sakte se neni 100 i Ligjit OS L-031, nuk vlene për ankesat administrative, pra, e precizon sakte nenin 100, se akti administrativ konsiderohet i miratuar ne heshtje, kur organi administrativ, heshte ndaj kërkesës se parashtruar. Dhe ne situatën tone, ne kemi parashtruar ankese (jo kërkesë), pranë OSHP-se, shkalles se dyte, dhe se shkalla e pare (AK) nuk ka hapësirë/fushëveprim, te vendos për një raport ne mes te OE dhe OSHP, pas ankesës se parashtruar.

4. Ne kundërshtim me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Ne kundërshtim me piken 44, e cila specifikon qarte, se kur mund te anulohet aktiviteti i prokurimit pas hapjes se ofertave, dhe se arsyetimi i anulimit, ne njoftimin e datës 15.04.2022, nuk është i bazuar ne asnjë nga rrethanat qe parasheh RRUOPP për anulim te procedurës se prokurimit.

RRUOPP (Artikulli 44) Ndërprerja e procedurave te prokurimit
44.6 Procedura e prokurimit pas hapjes se ofertave mund te anulohet për arsyen e mëposhtme:
(i) te gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime qe e tejkalojnë buxhetin e AK.

Ill. Kërkesa e OE
Duke pasur parasysh shkeljet te cilat i shtjelluam me larte, Autoriteti Kontraktues me veprimet/mosveprimet e tyre, kane injoruar totalisht dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, duke cenuar kështu edhe sigurinë juridike te prokurimit publik. Prandaj, me mirësjellje kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-se, qe sipas detyrës zyrtare dhe kompetencave
te saj, te autorizuar sipas ligjit:
Te aprovojnë site bazuar plotësisht ankesën tonë;
Te shfuqizoje njoftimin e AK-se, te datës 15.04.2022;
Te obligoj AK qe te vazhdoj me nënshkrim te kontratës, duke qene se ka një GOE te përgjegjshëm teknikisht dhe administrativisht, me një oferte brenda buxhetit te ndare për këtë projekt.
Te ndërmarr veprime ndaj AK për shkeljet procedurale te këtij autoriteti, ashtu qe te mos krijohet një precedent i tille, qe do r rrezikonte sigurinë juridike edhe ne procedurat e prokurimit ne te ardhmen.

KRITERET PËR VLERËSIM

N/ A

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE/OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "BOTEK" SH.P.K - PRISHTINË

Sqarim hyrës - Fillimisht sqarojmë se OE ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 20.04.2022 me pretendime të njëjta ankimore sikurse në këtë ankesë. AK me datë 22.04.2022 ka njoftuar përmes email-it OE ankues se Kërkesa për Rishqyrtim nuk ka bazë ligjore në këtë fazë, rrjedhimisht nuk i ka shqyzrtuar pretendimet ankimore.

Ashtu sikurse është sqaruar në Raportin e Eksperit Shqyrtues të datës 27.09.2021, ritheksojmë se sikurse përcaktohet me nenin 105 të LPP-së, ku thuhet se: "*… OSHP ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi, në kuadër të kushteve të saktësuara në këtë Pjesë IX që: 2.1. të shqyrtojnë ankesat nga palët e interesuara lidhur me shkeljet e mundshme të këtij ligji* " Eksperti Shqyrtues trajton pretendimet që lidhen me me veprimet e AK-së në raport me dispozitat e LPP-së, duke mos u lëshuar kështu në trajtimin dhe sqarimin e pretendimeve për shkeljen e dispozitave si dhe rrethanat faktike që supozohet kenë ndodhur jashtë fushëveprimit të dispozitave të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1 - OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke marrë vendim për përfundimin e aktivitetit të prokurimit.

AK me datë 15.04.2022 ka publikuar njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues, ku vendos të anulojë këtë aktivitet të prokurimit. Në vendimin përshkruhet arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik: "*Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit*". Më tej në pjesën V.2) Informacionet Shtesë ka dhënë informacionin shtesë "*MPB duke u bazuar ne Ligjin 05 L-031 për proceduren e përgjithshme administrative neni 135 pika 3, bënë njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit.*"

Sipas shkresave të lëndës AK ka ndërrmarr veprime për rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit pas Raportit të Ekspertit Shqyrtues të datës 27.09.2021, konkretisht ka kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues me datë 23.02.2022 si vijon " *Meqenëse vendosja për këtë aktivitet të prokurimit-tender, për shkak të*

Kërkesave për Ri-shqyrtim dhe ankesave në OSHP është zgjatur dhe ka kaluar një kohë e gjatë nga data e lëshimit të këtij autorizimi (13.11.2020), me qëllim të sqarimit të këtij dokumenti, komisioni i ri-vlerësimit kërkon të na sqaroni, të na dërgoni informacione shtesë se a është ky Autorizim i vlefshëm nga prodhuesi. Përgjigjja ose përgjigjet tuaja sqaruese duhet të pranohen prej Ju në adresën elektronike përmes platformës së E-prokurimit (Dorëzimi i dokumenteve në AK). Pa përgjigjen nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara deri më 25.02.2022 në orën 16:00, tenderi juaj do të refuzohet." OE ankues ka ridërguar Autorizimin e "Microsoft" të datës 13.11.2020.

Pas këtij veprimi sipas shkresave të lëndës nuk ka informatë tjetër për veprimet e AK deri në njoftimin për anulim të datës 15.04.2022.

Eksperti Shqyrtues rithekson se ashtu sikurse është sqaruar në raportin paraprak me numër të lëndës 683/21, të dates 27.09.2021, marrë për bazë nenet 62 dhe 112 të LPP-së si dhe interpretimet e KRPP-së për nenet e mësipërme, AK nuk ka diskrecion të heqë pezullimin e aktivitetit në këtë fazë. Dhe vendimi i AK-së për anulim nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga LPP për rastet kur mund të bëhet përfundimi i aktivitetit të prokurimit. Për me shumë arsyetimi i AK-së për tejkalim të afateve ligjore për vendimmarrje në OSHP bie ndesh me veprimin e vet AK-së për kërkesë për informacione shtesë të datës 23.02.2022. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

<u>Përgjigje në pretendimin ankimor 2</u> – OE ankues pretendon se AK nuk ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim pas vendimit të AK-së për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

AK me datë 15.04.2022 ka publikuar vendimin për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit. OE ankues me datë 20.04.2022 ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me pretendimet e njëjta ankimore si në këtë ankesë duke kundërshtuar vendimin për anulim. AK, me datë 22.04.2022 ka kthyer përgjigje përmes emailit se Kërkesa për Rishqyrtim nuk ka bazë ligjore në këtë fazë, rrjedhimisht AK nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore.

Eksperti Shqyrtues sqaron se ashtu sikurse përcaktohet me nenin 108/A, OE si palë e interesuar që mendon se të drejtat e tij janë shkelur nga vendimi i AK dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues. Dhe se AK do ta shqyrtojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar me nenin e mësipërm. Për me shumë ne vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit tek pjesa V.1) Ankesat, është dhënë informacioni si vijon: "*Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A te ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar*

me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. ligjin Nr. 05/L-092 ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi mbi anulimin e aktivitetit te prokurimit."

Andaj, bazuar në sqarimet e sipërpermenduara AK duke mos i shqyrtuar pretendimet ankimore të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave. Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE "Botek" Sh.P.K, të aprovohet si e bazuara dhe të anulohet vendimi i AK-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – "Botek" Sh.P.K, Prishtinë